



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

VENDIM
Nr. 457, datë 07.10.2021

PËR
PËRSËRITJEN E KOMANDIMIT TË GJYQTARES ZNJ. RUDINA PALLOJ
NË POZICIONIN E KËSHILLTARIT LIGJOR NË NJËSINË MBËSHTETËSE TË
KOMISIONEVE NË KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61, 86, shkronja “d” dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenet 53, 54 dhe 57, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 104, datë 05.07.2019 “Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtareve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit”, pasi shqyrtoi kërkesën e znj. Rudina Palloj, protokolluar në Këshill me aktin nr. 4514, datë 04.10.2021, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Përsëritjen e komandimit të gjyqtares znj. Rudina Palloj në pozicionin e “këshilltarit ligjor” në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për një afat deri në një vit.
2. Efektet juridike të vendimit fillojnë më datë 21.10.2021.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares së komanduar znj. Rudina Palloj sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR